FROM BIBLIOGRAPHICAL TRACKING TO CONTENT ANALYSIS: PARASHQEVI QIRIAZI'S PRIMER (BITOLA, 1909) AS AN OBJECT OF SCIENTIFIC RESEARCH AND ACTUALIZATION" AIMS TO EXAMINE THE BOOK "ABETARE - PËR SHKOLLAT E PARA" (PRIMER - FOR PRIMARY SCHOOLS)

GURMIMI BIBLIOGRAFIK DHE ANALIZA PËRPMBAJTËSORE: ABETARJA E PARASHQEVI QIRIAZIT (MANASTIR, 1909), SI OBJEKT I KËRKIMIT DHE AKTUALIZIMIT SHKENCOR

Zejnepe ALILI REXHEPI

Universiteti i Tetovës, Fakulteti Filologjik, Departamenti: Gjuhë dhe Letërsi Shqipe
zejnepe.rexhepi@unite.edu.mk

Abstrakt

Analizuar nga opusi i gjerë i letërsisë shqipe, tema bosht: "Nga kërkimi teorik në zbatimin praktik" ("From Research to Application" e Kongresit Ndërkombëtar të organizuar nga Universiteti i Tetovës, ofron dimensione mjaft interesante, pa e trajtuar thjesht si kalim nga teoria në praktikë, por si **shndërrim i rezultateve të hulumtimit letrar në vlera konkrete kulturore, arsimore dhe shoqërore.**
Punimi im studimor, me titull: "**Gjurmimi bibliografik dhe analiza përmbajtësore: Abetarja e Parashqevi Qiriazit (Manastir, 1909) si objekt i hulumtimit dhe aktualizimit shkencor"** synon të trajtojë librin "**ABETARE - për shkollat e para**" të Parashqevi Qiriazit, botuar në Manastir, në vitin 1909, fill pas mbajtjes së Kongresit të Manastirit - Kongresit të Alfabetit (1908), si një dokument me rëndësi të veçantë në historinë e arsimit, gjuhës dhe kulturës shqiptare.
Studimi mbi veprën "ABETARE - për shkollat e para, nuk mbështetet në të dhënat tashmë të publikuara të studiuesve tjerë, por drejtpërdrejt në tekstin e Abetares së kohës së Parashqevi Qiriazit, të shtypur më 1909, e cila më është dhuruar (kopje prej 27 faqesh) nga një studiues nga Athina. Me këtë rast, nuk e analizojmë dhe interpretojmë vetëm një tekst abetareje të vitit 1909, por të shënojmë edhe rrugëtimin e një dokumenti të vjetër me rëndësi të madhe për kulturën shkrimore dhe didaktike, nga ekzistenca bibliografike deri te njohja, analiza dhe vënia në shërbim të dijes së sotme.
Nisur nga procesi i gjurmimit dhe identifikimit bibliografik të veprës, studimi përqendrohet në shqyrtimin e strukturës, përmbajtjes, veçorive gjuhësore dhe metodologjisë didaktike të saj, bashkë me historinë e autores Parashqevi Qiriazi, që njihej si pedagoge, publiciste, autore tekstesh shkollore dhe delegate në Kongresin e Manastirit, prej ku edhe doli **Vendimi** për shtypjen e abetares, me shkronjat shqipe, si prurje e domosdoshme e njësimit të gjuhës shqipe me një abetare mbarëkombëtare.

Fjalë kyç: Parashqevi Qiriazi, Abetarja shqipe (1909), Kongresi i Manastirit (1908); historia e arsimit, dokument historik, trashëgimia e shkruar, analiza tekstologjike, identiteti kulturor, abetarja - vlerë mbarëkombëtare...

Abstract

Analyzed from the broad corpus of Albanian literature, the core theme: "From Research to Application" of the International Congress organized by the University of Tetova, offers fascinating dimensions-not merely treating it as a transition from theory to practice, but as the transformation of literary research outcomes into concrete cultural, educational, and social values.
My research paper, titled: "**From Bibliographical Tracking to Content Analysis: Parashqevi Qiriazi's Primer (Bitola, 1909) as an Object of Scientific Research and Actualization" aims to examine the book "ABETARE - për shkollat e para**" (*Primer - for primary schools*) by Parashqevi Qiriazi, published in Bitola in 1909, immediately following the Congress of Bitola - the Congress of the Alphabet (1908), as a document of special importance in the history of Albanian education, language, and culture.
The study on the work "ABETARE - për shkollat e para" does not rely on previously published data by other scholars, but directly on the text of Parashqevi Qiriazi's original primer of the period, printed in 1909, which was gifted to me (a 27-page copy) by a researcher from Athens. On this occasion, we analyze and interpret not only a primer text from 1909, but also trace the journey of an old document of great significance for written and didactic

https://doi.org/10.62792/ut.icfra.y2026.i2.pp135

culture, ranging from bibliographical existence to recognition, analysis, and its application in the service of contemporary knowledge.
Starting from the process of tracking and bibliographical identification of the work, the study focuses on examining its structure, content, linguistic features, and didactic methodology, alongside the history of its author, Parashqevi Qiriazi, who was known as a pedagogue, publicist, textbook author, and delegate to the Congress of Bitola—from which emerged the decision to print the primer in Albanian letters as an essential contribution toward the unification of the Albanian language through a pan-national primer.

Keywords: Parashqevi Qiriazi, Albanian Primer (1909), Congress of Bitola (1908), history of education, written heritage, textological analysis, cultural identity, the primer - a pan-national value...

Hyrje

Kërkimi i dokumenteve të trashëgimisë sonë të shkruar nuk përbën vetëm një proces të rikthimit të së kaluarës, por edhe mundësi për ta shndërruar atë në burim aktiv të dijes dhe të zhvillimit kulturor. Studimi i trashëgimisë letrare shqiptare, zbulimi dhe aktualizimi i materialeve të vjetra, në këtë rast një abetareje 117 vjeçare të krijon mundësi analize dhge interpretimi, jo vetëm për historikun e librit dhe të autorit, por edhe rëndësinë e përmbajtjes dhe interpretimin e tij si vlerë e identitetit kulturor.
Përmes temës së punimit: "**Gjurmimi bibliografik dhe analiza përmbajtësore: Abetarja e Parashqevi Qiriazit (Manastir, 1909) si objekt i hulumtimit dhe aktualizimit shkencor",** nga procesi i gjurmimit dhe identifikimit bibliografik të veprës, studimi përqendrohet në historinë e familjes atdhetare Qiriazi nga Manastiri, si dhe biobibliografinë e Parashqevi Qiriazit, e cila njihej si mësuese e shkollës së vajzave, aktiviste atdhetare, hartuese tekstesh shkollore dhe delegate në Kongresin e Manastirit (1908), prej ku doli **Vendimi** për shtypjen e abetares, me shkronjat shqipe, si prurje e domosdoshme e njësimit të gjuhës shqipe me një abetare mbarëkombëtare.
Abetarja e Parashqevi Qiriazit të jep mundësinë për një proces hulumtues, si dokument i një periudhe vendimtare (1908) që flet shumë edhe për vetë rëndësinë e Abetares së vitit 1909. Në këtë tekst nuk kemi të bëjmë vetëm me një përshkrim biografik të autores, apo historinë e abetares, por me dëshmi se një dokumenti historik mund të shndërrohet në njohuri dhe vlera të zbatueshme në studimet e sotme shqiptare, në lëmin krahasues dhe interpretues. Me një përkujdesje dhe vëmendje të posaçme duhet parë: përmbajtja e librit, shqyrtimi i strukturës, veçoritë gjuhësore dhe metodologjia didaktike e saj, shenjat/simbolet (figurat e vogla të përshtatura me temën e mësimit dhe shkronjën)..., bashkë me veprimtarinë arsimore dhe atdhetare të autores.
Nëpërmjet një qasjeje analitike dhe krahasuese, synohet të evidentohen vlerat e këtij botimi në kontekstin e zhvillimeve arsimore pas Kongresit të Manastirit, si dhe kontributi i Parashqevisë në hartimin e teksteve shkollore shqipe.
Gjurmimi dhe **identifikimi bibliografik** i abetares "ABETARE - për shkollat e para" e bën këtë libër me karakter të veçantë kërkimor. **Identifikimi** pas gjetjes së veprës është dokumentim i asaj vepre, që pason me **analizën e përmbajtjes**, **vlerave pedagogjike**, **gjuhësore** dhe **kulturore** të saj.
Vëmendje e veçantë i kushtohet mundësive të aktualizimit të këtij dokumenti përmes studimeve bashkëkohore, digjitalizimit dhe përfshirjes së tij në proceset e edukimit dhe të transmetimit të trashëgimisë kulturore.

“Gurmimi bibliografik dhe analiza përpmbajtësore: abetarja e parashqevi qiriazit (manastir, 1909), si objekt i kërkimit dhe aktualizimit shkencor “

Në Kongresin e Manastirit njëzëri është vendosur që në përdorim të alfabetit shqip të ishin shkronjat latine, e të mos shkruhej më me alfabet arab, grek ose turk. Ky qe një vendim i rëndësishëm, pasi njësimi i alfabetit, në një formë nënkuptonte edhe bashkëveprim kombëtar. Menjëherë pas mbajtjes së Kongresit së Alfabetit (1908) u themelua edhe shtypshkronja e Manastirit, atëkohë me 17 punonjës, në të cilën disa muaj më vonë u shtyp “**Abetare - Për shkollat e para**” (1909) me autore Prashqevi Qiriazin. Në të u shtypën edhe libra tjerë në gjuhën shqipe, si revista simbolike “Bashkimi i Kombit”.



Ballina e abetares origjinale

Ky studim mbi veprën “**ABETARE - për shkollat e para**”, nuk mbështetet në të dhënat tashmë të publikuara të studiuesve tjerë, por drejtpërdrejt në tekstin e abetares së kohës së Parashqevi Qiriazit, të shtypur më 1909, e cila më është dhuruar (kopje prej 27 faqesh, ku mungojnë 4-5 faqe) nga një studies nga Athina.
Analiza mbi tekstin e kësaj abetareje, e shenjon rrugëtimin e një dokumenti të vjetër me rëndësi të madhe për kulturën shkrimore dhe didaktike, nga ekzistenca bibliografike deri te njohja, analiza dhe vënia në shërbim të dijes së sotme bashkëkohore.
Nisur nga procesi i gjurmimit dhe identifikimit bibliografik të veprës, studimi përqendrohet në historinë e familjes atdhetare Qiriazi nga Manastiri, si dhe biobibliografinë e Parashqevi Qiriazit, e cila njihej si mësuese e shkollës së vajzave, aktiviste atdhetare, hartuese tekstesh shkollore dhe delegate në Kongresin e Manastirit (1908), prej ku doli **Vendimi** për shtypjen e abetares, me shkronjat shqipe, si prurje e domosdoshme e njësimit të gjuhës shqipe me një abetare mbarëkombëtare.
Nëpërmjet një qasjeje analitike dhe krahasuese, synohet të evidentohen vlerat e këtij botimi në kontekstin e zhvillimeve arsimore pas Kongresit të Manastirit, si dhe kontributi i Parashqevi Qiriazit në hartimin e teksteve shkollore shqipe. Vëmendje e veçantë i kushtohet mundësive të

aktualizimit të këtij dokumenti përmes studimeve bashkëkohore, digjitalizimit dhe përfshirjes së tij në proceset e edukimit dhe të transmetimit të trashëgimisë kulturore.
Hulumtimi i dokumenteve të trashëgimisë sonë të shkruar nuk përbën vetëm një proces të rikthimit të së kaluarës, por edhe mundësi për ta shndërruar atë në burim aktiv të dijes dhe të zhvillimit kulturor. Studimi i trashëgimisë letrare shqiptare me aktualizimin dhe përdorimin e saj në edukim, interpretim dhe ruajtje të identitetit kulturor është mjaft me rëndësi.
Abetarja e Parashqevi Qiriazit të jep mundësinë për një proces hulumtues, si dokument i një periudhe vendimtare (1908) që flet shumë edhe për vetë rëndësinë e Abetares së vitit 1909. Në këtë tekst nuk kemi të bëjmë vetëm me një përshkrim biografik të autores, apo historinë e abetares, por me dëshmi se një dokument historik mund të shndërrohet në njohuri dhe vlera të zbatueshme në studimet e sotme shqiptare, në lëmin krahasues dhe interpretues. Me një përkujdesje dhe vëmendje të posaçme duhet parë: **përmbajtja e librit**, **shqyrtimi i strukturës**, **veçoritë gjuhësore** dhe **metodologjia didaktike**j, **shenjat/simbolet** (figurat e vogla të përshtatura me temën e mësimit dhe shkronjën)..., bashkë me **veprimtarinë arsimore dhe atdhetare** të autores.
Gjurmimi dhe **identifikimi bibliografik** i abetares, e bën këtë vepër me karakter të veçantë kërkimor.
Identifikimi pas gjetjes së veprës është dokumentim i asaj vepre, që pason me **analizën e përmbajtjes**, **vlerave pedagogjike**, **gjuhësore** dhe **kulturore** të saj.
Atëherë, kur **Bibliografia** e Bibliotekës Kombëtare të Shqipërisë e regjistron botimin e vitit 1909 me 32 faqe, ilustrime dhe format 22 cm, ajo jo vetëm që e cilëson si tekstin e parë shkollor të shkruar me alfabetin e miratuar në Kongresin e Manastirit (1908), por Abetaren e Parashqevi Qiriazit (1909) e shenjon si **dokument i trashëgimisë arsimore shqiptare.**


ABETARE
Prej
P. D. Qirias
Për shkollat e para
Shtypurë prej Shoqërisë
„Botonjëse Literare"
MANASTIR
Ctypckrona „BAGKIM' I KOMBIT"
1909.

Ballina e abetares (kopje)

Në ***ballinën 1*** dhe ***ballinën 2*** të abetares (njëra origjinali dhe tjetra kopje), shihet se Abetarja nuk është thjesht një libër fillestar për shkollat e para të një periudhe kohore, por një riprodhim i domosdoshëm për rëndësinë dhe vlerat historike dhe kombëtare.
Abetarja, si tekst elementar i **mësimit logjik** dhe **edukimit gjuhësor**, përfaqëson një strukturë të ndërthurur mësimore, ilustrative dhe kulturore, në të cilën **alfabeti** (shkronjat), **fjala** dhe **figura** (vizatimi) shndërrohen në mjete të përçimit të dijes dhe të formimit të vetëdijes kombëtare.

Abetarja - përshkrim logjik, ilustrativ, historik dhe gjuhësor

Abetarja nuk është thjesht libër fillestar për mësimin e shkronjave dhe të leximit. Ajo përfaqëson një nga mjetet më të rëndësishme të formimit arsimor, gjuhësor dhe kulturor të kombit. Në historinë e arsimit shqiptar, Abetarja ka rëndësi të veçantë, sepse përmes saj alfabeti është shndërruar në dije të shkruar, ndërsa gjuha shqipe e ka gjetur rrugën më të drejtpërdrejtë të përhapjes dhe të institucionalizimit të saj.
Në vijim, duke e ndërthurur përshkrimin me interpretimin shkencor, përmbajtjen e abetares do ta trajtojmë në rrafshin logjik.

1.Rrafshi logjik - struktura dhe funksioni pedagogjik

Nga pikëpamja logjike, Abetarja ndërtohet mbi një renditje të qëndrueshme didaktike, e cila e udhëheq nxënësin nga njohja e elementeve më të thjeshta drejt njësive më të ndërlikuara gjuhësore.
Procesi zakonisht zhvillohet në këtë rend:

- Njohja e shkronjave dhe e tingujve përkatës.
- Lidhja e tingullit me shenjën grafike.
- Formimi i rrokjeve.
- Ndërtimi i fjalëve.
- Formimi i fjalive.
- Leximi dhe kuptimi i teksteve të shkurtra.

Në këtë renditje shihet parimi themelor pedagogjik: kalimi nga e thjeshta te e ndërlikuara, nga konktretja te abstraktja dhe nga njohja individuale e shenjave te komunikimi gjuhësor.

Shembull: Njohja e shkronjave dhe e tingujve përkatës.



Shembull: Formimi i rrokjeve



Shembull: Ndërtimi i fjalëve



Kafɕɛ	gamiʎɛ	rosɛ
kalɛ	qɛn	puʎumb
gomar	maimun	lelek
ka	ndre	lopɛ
delendryɕɛ	ljepur	rabeckɛ
mɛɕqerɛ	mace	bilbil
ḑelɛ	mi	foɟe
qenq	ɕpesɛ	pɛndɛ
kec	zok	peɕk
der	ɕqipoɳɛ	garpɛr
luan	kɛndes	bretkosɛ
ari	pulɛ	krimp
ðelprɛ	vezɛ	mizɛ
ujk	paun	mbletɛ
tigri	patɛ	mjaltɛ
qieʎ	botɛ	luaði

Shembull: Formimi i fjalive.



Ma - nu - ɕa - qe

Manuɕaqe

Manuɕaqja ɛɕtɛ ɳɛ lule e bukur.
Manuɕaqja çelet ndɛ kohɛ tɛ verɛs.
Ka erɛ fort tɛ bukur. Nesɛr dot' i
sjeʎ mɛsoɳɛses ɳɛ tufɛ manuɕaqe.

2. Rrafshi ilustrativ - dimensioni pamor dhe simbolik

Ilustrimet në abetare nuk kanë vetëm funksion zbukurues (dekorativ). Ato përbëjnë një element arsimor që ndihmon në përcaktimin kuptimor të fjalës, në zhvillimin e imagjinatës dhe krijimin e lidhjeve ndërmjet objektit, figurës, tingullit dhe kuptimit.
Në këtë kuptim, ilustrimi është një formë komunikimi pamor që plotëson komunikimin gjuhësor. Përmes figurave të njerëzve, kafshëve bimëve, objekteve të përditshme dhe mjedisit jetësor, fëmija/nxënësi e lidh botën që njeh me botën e fjalëve që fillon të mësojë.
Ilustrimet mund të kenë edhe funksion identitar, ato pasqyrojnë mjedisin shoqëror, natyrën, traditën, veshjet, zakonet, dhe përditshmërinë e një bashkësie kulturore.









3.Rrafshi historik - Abetarja si dëshmi e kujtesës kombëtare

Historikisht, abetarja shqiptare "**Abetare - për shkollat e para**" (1909) e Parashqevisë, është e lidhur ngushtë me përpjekjet për shkrimin, përhapjen dhe mësimin e gjuhës shqipe. Kjo abetare ka rëndësi të veçantë, sepse është teksti i parë shkollor i hartuar me alfabetin e njësuar në Kongresin e Manstirit (1908) dhe përfaqëson një hap të rëndësishëm në kalimin nga përpjekjet për krijimin e alfabetit të përbashkët drejt zbatimit të tij në praktikën shkollore.
Kjo abetare, në rrafshin historik, nuk qëndron e vetme, pasi ajo ndërlidh vazhdimësinë e hershme të kësaj tradite, nga Naum Veqilharshi me abetaren **"Ëvetari"** (1844), i cili shënon një etapë të rëndësishme në përpjekjet për arsimimin në gjuhën shqipe. Mandej, Konstandin Kristoforidhi **"Abetare skip"** (1867, 1869, 1872); Jani Vreto, Sami Frashëri, Pashko Vasa dhe Koto Hoxhi (bashkautorë) në **"Albetare e gjuhësë shqip"** (1879); Sami Frashëri **"Abetare e gjuhësë shqip"** (1886, 1888, 1900); Ndre Mjeda **"Këndime për shkollë të para"** (1904); Luigj Gurakuqi **"Abetari për mësojtore filltare t'Shqypnis"**, Parashqevi Qiriazi **"Abetare - për shkollat e para"** (1909).

Kthesa vendimtare për një alfabet të njësuar të kombit shqiptar ishte alfabeti shqip, i mbështetur i tëri në alfabetin latin (25 shkronja gjithsej); shkronjat që plotësoheshin me nëntë digrame (shkronja dyshe) si: **dh, gj, ll, nj, rr, sh, th, xh, zh,** si dhe dy shkronjat me shenja diakritike: **ç, ë**. Për këtë solli vendim Komisioni dhe Kongres i Albabetit - Kongresi i Manastirit (14 - 22 Nëntor 1908), bashkë me lejimin në përdorim të *Alfabetit të Stambollit*, që kishte përhapje të gjerë ndër shqiptarët, ashtu edhe i alfabetit të ri. Dy alfabetet e pranuara ndryshonin vetëm në shtatë shkronja. Me këtë u arrihet **njësimi i alfabetit shqip**. Ky zhvillim krijoi kushte më të favorshme për hartimin dhe përdorimin e teksteve shkollore të përbashkëta.
Në këtë histori zë vend të rëndësishëm Parashqevi Qiriazi. Abetarja e saj, e botuar në fillim të shekulli XX, lidhet me përpjekjet për përhapjen e arsimit shqip dhe me emancipimin arsimor të shoqërisë shqiptare. Po ashtu, shënon një etapë të veçantë: si abetarja e hartuar nga një grua, me alfabetin e njësuar të Kongresit të Manastirit. Prandaj, abetarja mund të lexohet edhe si dokument historik, pasi dëshmon jo vetëm zhvillimin e metodave të mësimdhënies, por edhe kushtet politike, shoqërore e kulturore në të cilat është zhvilluar arsimi shqiptar.

4.Rrafshi gjuhësor - alfabeti dhe ndërtimi i gjuhës

Nga pikëpamja gjuhësore, Abetarja është një tekst themelor për përvetësimin e sistemit të shkrimit të një gjuhe. Ajo paraqet marrëdhënien ndërmjet tingullit dhe shkronjës, ndërmjet shqiptimit dhe paraqitjes grafike, duke e ndihmuar nxënësin të kuptojë mekanizmin e funksionimin e gjuhës së shkruar.
Abetaret janë libra, ku bëhet organizimi i shkronjave dhe renditja e tyre alfabetike nga ***A – a*** ***tek ZH – zh***, që parqet rrjedhshmërinë e tingujve, më pas rrokjeve, fjalëve, fjalive dhe teksteve të shkurtra. Përmes fjalëve pasurohet fjalori dhe përzgjedhja leksikore, ndërsa sipas fjalëve përcaktohen lustrimet që gjithashtu vihen në shërbim të mësimit.
Raporti ndërmjet fjalës, tekstit dhe figurës (ilustrimit) e krijon procesin e të nxënit mbi bazën e alfabetit të njësuar.
Në këtë rrafsh duhen shqyrtuar disa elemente:

- **Sistemi alfabetik:** paraqitja dhe renditja e shkronjave, si dhe mënyra e përfaqësimit të tingujve të shqipes.
- **Fonetika:** lidhja ndërmjet tingujve dhe shenjave grafike, dallimi i zanoreve dhe bashkëtingëlloreve.
- **Fonologjia:** funksioni dallues i tingujve në formimin e fjalëve.
- **Morfologjia:** njohja e fjalëve dhe e formave të tyre gramatikore.
- **Sintaksa:** ndërtimi i fjalive të thjeshta dhe kuptimi i marrëdhënieve ndërmjet fjalëve.
- **Leksiku:** përzgjedhja e fjalëve të përdorura, pasuria e tyre kuptimore dhe lidhja me jetën e përditshme.

Vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet edhe gjuhës së përdorur në tekst: nivelit të saj leksikor, qartësisë së shprehjes, strukturës së fjalive, normës drejtshkrimore dhe përshtypjes me moshën e lexuesit.
Në rastin e abetareve historike, ky shqyrtim bëhet edhe më interesant, sepse përmes tyre mund të vërehen ndryshimet në sistemin e shkrimit, në përdorimin e fjalëve dhe në zhvillimin e normës së shqipes.
Siç shohim nga emërtimet e pothuajse të gjitha abetareve të autorëve të periudhës së Rilindjes, ato lidhen drejtpërdrejt me kuptimin e fjalës si qëllim i të nxënit, p.sh.: **Ëvetar shqip, Abetare e gjuhës shqipe, Abetare skip, Alfabetare, Pellazgjika shqip alfavitar, Abetare e gjuhësë shqip, Grammë për shqiptarë, Këndime për shkollë të para, Abetare për mësoitore filltare t'Shqypnis…,** që përpos rëndësisë së mësimdhënies së gjuhës shqipe përfaqësojnë edhe vlera kombëtare dhe kulturore.
Abetarja shqipe mbetet vlerë e përparimit përmes dijes dhe arsimit.

5.Abetarja e Parashqevi Qiriazit - një rast me rëndësi të veçantë studimore

Abetarja e vitit 1909 ka rëndësi të veçantë, pasi konsiderohet teksti i parë shkollor i hartuar me alfabetin e njësuar në Kongresin e Manstirit, andaj përfaqëson një hap të rëndësishëm në kalimin nga përpjekjet për krijimin e alfabetit të përbashkët drejt zbatimit të tij në praktikën shkollore.
Në këtë analizë është me rëndësi:
Vlera gjuhësore qëndron në tërësinë e librit; zhvillimin e alfabetit përmbajtjen, kuptimin dhe porosinë e njësive mësimorem; drejtshkrimin dhe përdorimin e shqipes.
Dimensioni kulturor: përmbajtja dhe tematika e njësive mësimore, të hartuara në bazë të vlerave, traditës dhe njohjes së botëkuptimeve të jetës në shoqërinë shqiptare, gjithmonë me një frymë edukuese dhe përparimtare.
Rëndësia historike: Çfarë roli luajti në përhapjen e arsimit shqip pas Kongresit të Manastirit? Meqenëse tema e kongresit ishte **Njësimi i alfabetit**, vetë realizimi i tij abetare e Parashqevisë e bën një dokument të rëndësishëm të kohës dhe pas si libër i përfshirë në programet mësimore dhe veprimtarinë arsimore dhe kulturore.
Ruajtja e këtij libri origjinal me vlerë për shqiptarët, në Arkivin Shtetëror të Tiranës dhe në Bibliotekën Kombëtare të Tiranës, ofron mundësi duhet përdorimi të saj në studimet e historisë së gjuhës dhe të pedagogjisë, por me digjitalizimi e dokumentit, përdorimi i tij për qëllime studimore, si dhe krahasimi me abetaret e periudhave tjera të mëhershme, por edhe këtyre të kohës bashkëkohore, do të mundësonte një zhvillimin më të mirë për metodologjisë së mësimdhënies**.**
Abetarja mund të konsiderohet njëkohësisht dokument letrar, pedagogjik, gjuhësor, historik, dhe kulturor. Ajo nuk e kufizon funksionin e saj vetëm në mësimin e shkrim-leximit, por bëhet edhe bartëse e kujtesës, e identitetit dhe e vetëdijes gjuhësore. Me Abetaren e Parashqevi Qiriazit, këto dimensione marrin rëndësi të veçantë, sepse vepra e saj lidhet me një moment vendimtar të historisë së alfabetit dhe të arsimit shqip.



Shoqnia Bashkimi 1899, në Shkodër.

- Alfabeti shqip -

A a	B b	C c	Ç ç	D d	Dh dh	E e	Ë ë	F f
a	bë	cë	çë	dë	dhë	e	ë	fë
[a]	[b]	[ts]	[ʧ]	[d]	[ð]	[ɛ]	[ə]	[f]
G g	Gj gj	H h	I i	J j	K k	L l	Ll ll	M m
gë	gjë	hë	i	jë	kë	lë	llë	më
[g]	[ɟ]	[h]	[i, j]	[j]	[k]	[l]	[ɫ]	[m]
N n	Nj nj	O o	P p	Q q	R r	Rr rr	S s	Sh sh
në	një	o	pë	që	rë	rrë	së	shë
[n]	[ɲ]	[ɔ]	[p]	[c]	[ɾ]	[r]	[s]	[ʃ]
T t	Th th	U u	V v	X x	Xh xh	Y y	Z z	Zh zh
të	thë	u	vë	xë	xhë	y	zë	zhë
[t]	[θ]	[u]	[v]	[ʣ]	[ʤ]	[y]	[z]	[ʒ]

Abetare e shoqnisë “bashkimi” në shkodër, 1899.



“Abetarja e gjuhës shqipe”, e botuar në vitin 1897 dhe e përgatitur nga: sami frashëri, vaso pasha dhe koto hoxhi.



Abetare e gjuhës shqipe nga sami bej frashërit

Abetarja e parashqevi qiriazit, botimi i vitit 1908 dhe 1911.





Përfundim

Qëllimi i Kongresit të Manastirit (1908) ishte **Njësimi i alfabetit**, prandaj kërkimi i dokumenteve të trashëgimisë sonë të shkruar nuk përbën vetëm një proces të rikthimit të së kaluarës, por edhe mundësi për ta shndërruar atë në burim aktiv të dijes dhe të zhvillimit kulturor. Studimi i trashëgimisë letrare shqiptare me aktualizimin dhe përdorimin e saj në edukim, interpretim dhe ruajtje të identitetit kulturor është mjaft me rëndësi.
Abetarja mund të konsiderohet njëkohësisht dokument letrar, pedagogjik, gjuhësor, historik, dhe kulturor. Ajo nuk e kufizon funksionin e saj vetëm në mësimin e shkrim-leximit, por bëhet edhe bartëse e kujtesës, e identitetit dhe e vetëdijes gjuhësore. Me Abetaren e Parashqevi Qiriazit, këto dimensione marrin rëndësi të veçantë, sepse vepra e saj lidhet me një moment vendimtar të historisë së alfabetit dhe të arsimit shqip.
Hartimi i abetares "Abetare - për shkollat e para" a e Parashqevisë e bën një dokument të rëndësishëm të kohës dhe më pas si libër i përfshirë në programet mësimore dhe veprimtarinë arsimore dhe kulturore.
Ruajtja e këtij libri origjinal me vlerë për shqiptarët, në Arkivin Shtetëror të Tiranës dhe në Bibliotekën Kombëtare të Tiranës, ofron mundësi përdorimi të saj në studimet e historisë së gjuhës dhe të pedagogjisë, por me digjitalizimi e dokumentit, përdorimi për qëllime studimore, si dhe krahasimi me abetaret e periudhave tjera të mëhershme, por edhe këtyre të kohës bashkëkohore, do të mundësonte një zhvillimin më të mirë për metodologjisë së mësimdhënies**.**

Referencat

[1] Durham, Edith.: "Brenga e Ballkanit", Tiranë, 1991;
[2] Kraja, Musa.: "Mësuesit për Kombin Shqiptar", Botimet "Toena", Tiranë, 1993;
[3] Arkivi Shtetëror i Shqipërisë, Tiranë;
[4] Biblioteka Kombëtare e Tiranës;
[5] Eqrem Çabej, "Studime gjuhësore II", "Rilindja, Prishtinë, 1976;
[6] Gjergji, Sarë.: "Stublla me shkollën e parë shqipe (1584 - 1905), Lidhja e Shkrimtarëve të Kosovës, Prishtinë, 2014;
[7] Frashëri, Sami.: "Gjuha shqipe", në "Alfabetare e gjuhësë shqip", Konstandinopojë, 1879;

[8] Gazeta “Përlindja e Shqipnisë”, nr. 8, Tiranë, 8 shtator 1913;
[9] AQSH, Fondi klubi shqiptar “Bashhkimi” i Manastirit, D.10, fl.335; D.2, Dok. 7464. Shih edhe HHStA,PA, A. (Informacion i konsullit austriak), nr. 71, Manastir, 14 nëntor 1908; nr. 64, Manastir, 23 Nëntor 1908;
[10] Jubileu i Kongresit të Manastirit (1908 - 2003) - 95 vjet Bashkim Gjuhësor, Manastir, 2003.
[11] Demiraj, Shaban & Prifti, Naum.: “Kongresi i Manastirit”, ASHSH - Instituti i Historisë Tiranë, 2004;
[12] Revista “Letra e gjallë”, Viti VII, nr. 14, qershor - shtator 2004.